

KONTRATE
SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 24 . 01 . 2019 (dymijë e nentembëdhjetë),

Shoqëria BLG Shpk, në cilësinë e shitësit, me seli në Rrugën Tercilio Kardinali, Njësia Bashkiake numër 11, Ndërtesa 10, Kati2, Shkalla 1, Apartamenti. 2, me NUIS/NIPT L71603025P, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj ligjor, Z. Massimiliano Nicolini, shtetas italian, i datëlindjes 16.11.1976, lindur në Brescia (Itali) me banim në Tiranë, madhor me zotësi te plote juridike për të vepruar, i pajisur me pasaportë numër YA 1831944, e vlefshme deri më 01.03.2021, në cilësinë e ortakut të shoqërisë Musa Albania Sh.P.K , i cilësuar këtu e në vijim si **“Shitesi”**;

Shoqëria EMD Madencilik Sanayi Ve Ticaret A.S(EMD), në cilësinë e blerësit, shoqëri e të drejtes, e regjistruar si person juridik në formën e Shoqërisë Anonime, me NUIS/NIPT Maslak: V.D.No 3330796284 e përfaqësuar nga Administratori Z. Atilla GURKAN i lindur me datë 02/06/1946 në Turqi, i pajisur me mjetin e identifikimit pasaportë/leternjoftim me numër 13097449232, i cilësuar këtu e në vijim si **“Blerësi”**.

Të cilësuarat vecmas dhe bashkëisht si **“Palët”**.

Bazuar në faktin që ndërmjet palëve është nënshkruar kontrata e bashkëpunimit e datës 21.11.2018 (e cila i bashkëlidhet kësaj kontrate si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj) e cila përcakton në nenin 1 detyrimin e palëve për nënshkrimin e kontratës për kalimin e pronësisë mbi një pjesë prej 5% të kuotave të shoqërisë MUSA ALBANIA Sh.P.K. person juridik shqiptar regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS/NIPT L81821024M;

Bazuar në vullnetin e palëve për përmbushjen e detyrimeve kontraktore të marra përsipër me kontratën e datës 21.11.2018;

Bazuar në qëllimin e përbashkët të palëve për krijimin dhe zhvillimin e një veprimtarie të përbashkët ekonomike për përmbushjen e objektivave dhe qëllimeve respektive të palëve në synim të nënshkrimit të një kontrate koncesionare me shtetin shqiptar sipas parashikimeve të kontratës së datës 21.11.2018;

Bazuar në nenet 659 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 1 e në vijim të kontratës së datës 21.11.2018 të lidhur ndërmjet palëve,

Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë palët vendosin të redaktojnë dhe nënshkruajnë kontratën si më poshtë vijon:



EMD MADENCILIK SANAYI VE TIC. A.Ş.
Maslak Mah. Büyükdere Cad. No:243 Bağımsız
Bölüm 38 Şişli Beşler Mahallesi İSTANBUL
Gsm:0938 356 8520 Tic.Sic. No: 45801-5
Maslak V.D. 333 079 6284
Mersis No: 0933 0796 2840 0016

Neni 1
Qëllimi dhe objekti kontratës

1. Qëllimi i kontratës është kalimi i pronësisë së sendeve të luajtshme të patrupëzuara të cilat zotërohen në mënyrë të plotë dhe të pacuënuar nga pala shitëse.
2. Objekti i kontratës është kalimi i pronësisë së 1 kuote, të barabartë me 5% (pesë pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë MUSA ALBANIA Sh.P.K. e cila zotërohet nga ortaku themelues BLG ShP.K. në cilësinë e shitësit në favor të shoqërisë **EMD Madencilik Sanayi Ve Ticaret A.S (EMD)** në cilësinë e blerësit.
3. Pronësia e shitësit mbi kuotën objekt kontrate vërtetohet nga Ekstrakti i thjeshtë i shoqërisë MUSA ALBANIA Sh.P.K. i të njëjtës datë me datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pjesë përbërëse dhe e pandashme e saj.

Neni 2
Çmimi dhe pagesa

1. Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së objektit të kontratës, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 1 të saj të jetë i barabartë me 1.300.000 (një million e treqind mijë).
2. Shuma që përbën çmimin e përcaktuar për kalimin e pronësisë së kuotës do të derdhet në llogarinë e Shitësit sipas ekstremiteve bankare bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e kësaj kontrate jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga miratimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë MUSA Albania Sh.P.K. për miratimin e shitjes së kuotës në favor të blerësit..

Neni 3
Pronësia dhe transferimi i kuotave

1. Pala shitëse i garanton palët blerëse se kuotat janë të lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj të tretëve dhe për çdo pretendim që mund të ngrëne të tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar të paraqitet me kërkesën e palëve blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.
2. Pala blerëse përjashtohet nga çdo detyrim administrative financiar apo ligjor ndaj vetë shoqërisë në cilësinë e ortakut, apo ndaj të tretëve, për pretendimet e tyre ndaj shoqërisë MUSA Albania Sh.P.K. deri në botimin në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë të njoftimit për shpalljen fituese të kontratës koncesionare sipas parashikimeve të kontratës së datës 21.11.2018 të lidhur ndërmjet palëve.
3. Pala shitëse merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga cilësia e ortakut të palës blerëse deri në botimin në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë të njoftimit për shpalljen fituese të kontratës koncesionare sipas parashikimeve të kontratës së datës 21.11.2018 të lidhur ndërmjet palëve



EMD MADENCILIK SANAYI VE TIC. A.Ş.
Maslak Mah. Büyükdere Cad. No:243 Bağımsız
Böfüm 38 Spine Tower Şişli-İSTANBUL
Gsm:0538 958 86 20 Tic.Sic. No: 45801-5
Maslak V.D. 333 079 6284
Mersis No: 0333 0796 2840 0016

Sa parashikuar në dispozitat kontraktuese të mësipërme, në përputhje me nenin 686 te Kodit Civil Shqiptar, palët deklarojnë se pranojnë dhe miratojnë veçmas Nenet 2 dhe 3 të saj.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi, shoqëria BLG Sh.P.K ortak themelues i shoqërisë MUSA ALBANIA Sh.P.K zhvishet nga pronësia e 1 (një) koute me përqindje 5% (pesë pikë përqindje) të kapitalit themeltar dhe bleresi Shoqëria EMD Madencilik Sanayi Ve Ticaret A.S bëhet zotërues i 1 (një) koute me përqindje 5% (pesë pikë përqindje) të kapitalit themeltar.

PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE

BLG SHPK

Z. Massimiliano Nicolini



PALA BLERËSE

EMD Madencilik Sanayi Ve
Ticaret A.S

Z. Atilla Gurkan

EMD MADENCILIK SANAYI VE TIC. A.Ş.
Maslak Mah. Büyükdere Cad. No:243 Bağımsız
Eđilüm 38 Spine Tower Gariyer-İSTANBUL
Tic.Sic.No: 45801-5
Maslak V.D. 337 079 5284
Mersis No: 333 0795 2840 0016